

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-AKP-A-44/11

Prishtinë

15 Qershor 2011

Në procedurën e

R.B.P.

E përfaqëson **M.M.M.**

18400 Prokuplje, Rruga 3 gusht, No. 6, Serbi

Paditësi/Ankuesi

Kolegji Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Antoinette Lepeltier-Durel, kryetare, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/84/2010, (dosja e lëndës e regjistruar në AKP, nën numrin AKP 47391, i datës 2 shtator 2009, pas diskutimit të mbajtur më 15 Qershor 2011, lëshon këtë

AKTGJYKIM

1- Pranohet ankesa e R.P..

**2- NDRYSHOHET Vendimi i Komisionit për Ankesa Pronësore i Kosovës
KKPK/D/A/84/2010, i datës 2 shtator 2010, në pjesën e tij që ka të bëjë**

me kërkesën e paraqitur më 30 nëntor 2007, nga M.M. në emër të R.P.-it dhe të regjistruar nën Nr. AKP 47391, dhe gjykohet.

- 3- PRANOHET Kërkesa e R.P. e paraqitur më 30 nëntor 2007 dhe e regjistruar nën Nr. KPA 47391.
- 4- Vërtetohet e drejta e pronësisë së R.P.-it mbi ngastrën e tokës Nr. 1365/1, me një sipërfaqe prej 0 ha,08 a, 79 m2, që gjendet në vendin e quajtur “Osoja te Osja”, Zona Kadastrale e Batllavës, në Komunën e Podujevës.
- 5- R.P.-it i jepet në posedim pasuria kërkuar – objekt kontesti në këtë lëndë.
- 6- Personi i cili uzurpon pasurinë duhet ta lirojë atë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e këtij vendimi; në rast të mosveprimit në pajtim me këtë urdhëresë, brenda afatit të përmendur, personi duhet të dëbohet nga prona përmes ekzekutimit me dhunë..
- 7- Shpenzimet e procedurës mbulohen nga gjykata dhe pagesa bëhet nga burimet buxhetore.

Historiku faktik dhe procedural:

Më 30 nëntor 2007, M.M. ka paraqitur një kërkesë në Agjencionin Kosovar të Privatizimit (AKP) në emër të vjehërrit të tij, i cili gjendet i shtrirë në spital dhe është invalid, përmes të cilës kërkon vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe ri-posedimin e ngastrës tokësore Nr.1365/1, me një sipërfaqe prej 0 ha, 8 ar, 79 m2, që gjendet në vendin e quajtur “Osoja te Osja”, Zona Kadastrale e Batllavës, në Komunën e Podujevës.

Ai ka pohuar se vjehërrin e tij është pronar i pasurisë në fjalë, posedimin e të cilës e kishte humbur më 15 qershor 1999, ngastër kjo e cila është uzurpuar nga një person i panjohur.

Për ta mbështetur kërkesën, ai në AKP ka paraqitur Vendimin D. Nr. 51/73, të lëshuar më 06 shtator 1985, nga Gjykata Komunale e Podujevës, ku flitet për ndarjen me gjyq të ngastrave të ndryshme e në veçanti për atë të R.P.-it. Ai gjithashtu ka siguruar edhe Vendimin 04 Nr. 466-48/92 të Komunës së Podujevës të lëshuar më 3 qershor 1993, ku atij dhe një tjetër personi i njihet e drejta e çasjes së pronën e tyre përmes ngastrës Nr. 2495, e cila gjendet në fshatin Batllavë.

Sekretariati ekzekutiv i AKP-së ka bërë publikimin e kërkesës më 5 qershor dhe njoftimin më 10 nëntor 2009, duke vënë një poster në këtë ngastër, i cili ishte vendosur sipas koordinatave dhe ortofotos së GPS. Nuk është gjetur asnjë uzurpator. Meqë asnjëri nga të palët përgjegjëse nuk ka paraqitur përgjigje brenda afatit të paraparë, kërkesa është konsideruar si e pakontestueshme.

Raporti verifikues i AKP-së, ka pohuar validitetin e vendimit të Gjykatës Komunale të Podujevës. Sekretariati Ekzekutiv, sipas detyrës zyrtare, në dosjen e lëndës ka shikuar listën poseduese Nr. 338 të Zonës Kadastrale të Batllavës, Komuna e Podujevës, dhe ka parë se ngastra në fjalë është e regjistruar në emër të R.P..

Disa herë në mes të shtatorit 2008 dhe marsit 2009, Sekretariati Ekzekutiv ka kërkuar, por pa sukses, nga M.M. që ta dorëzojë autorizimin e tij të avokatit të dhënë nga R.P..

Me vendimin e tij të datës 2 shtator 2009, Komisioni i Kërkesave Pronësore i Kosovës (KKPK) ka hedhur poshtë këtë kërkesë për arsye se M.M. nuk ishte pjesëtar i familjes siç e përcakton Neni 1 i Rregullores Administrative të UNMIK-ut (RrA) 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pasurinë e patundshme private, përfshirë këtu edhe pasurinë bujqësore dhe tregtare, dhe se ai nuk i ka sjellë AKP-së autorizimin e avokatit, ndonëse atij i janë dhënë shumë raste për ta bërë këtë.

M.M. ka marrë vendimin e KKPK-së më 24 shkurt 2011 dhe më 24 mars 2011 ai ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të përmendur.

Në ankesën e tij, M.M. ka pohuar se ai, përmes faksit, dy herë e kishte dërguar autorizimin e avokatit në AKP dhe Gjykatës Supreme i kishte dhënë autorizimin e avokatit, të nënshkruar nga R.P. dhe të vërtetuar më 23 mars nga Gjykata e Prokupljes në Serbi.

Arsyet ligjore:

Vendimi i shkallës parë ishte dërguar më 24 shkurt 2011. Sipas Nenit 121 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-079, pala mund të paraqet ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi për këtë vendim. M.M., në emër të R.P.-it me kohë, më 24 mars 2011, ka paraqitur ankesën e tij.

Gjykata Supreme konsideron se KKKPK-ja ka zbatuar me përpikëri rregullat që kanë të bëjnë me përfaqësimin e palës. Mirëpo, ajo gjenë se vendimi i ankimuar ishte marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të ligjit të procedurës për arsye se përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës nuk i ishte kërkuar zyrtarisht ta korrigjonte dhe ta plotësonte kërkesën me një referencë për t'ia tërhequr vëmendjen e tij për pasojat në rast të mos veprimit të tij në përputhje me atë kërkesë.

Lidhur me përfaqësimin e palës, Neni 5.2 i Udhëzimit të ndryshuar Administrativ 2007/5 thotë:

“Në procedurë para Komisionit, kur një person fizik nuk mundet të bëjë ankesë, kërkesën mund ta bëjë një anëtar i familjes së atij personi. Paraqitësin e kërkesës mund ta përfaqësojë një person i autorizuar fizik me një autorizim valid dhe të dubur të avokatit. Në raste të veçanta, kur sigurimi i autorizimit është problematik, Sekretariati Ekzekutiv mund ta vërtetojë një dokument alternativ me të cilin e autorizon përfaqësimin e paraqitësit të kërkesës.”

Sipas Nenit 1 të Udhëzimit të njëjtë administrativ, “pjesëtari i familjes” nënkupton gruaja, fëmijët dhe personat tjerë të cilët të cilët mbajtësi i familjes është i detyruar ti mbështes, në pajtim me ligjin në fuqi apo personat të cilët janë të obliguar ta mbështesin mbartësin e të drejtës së pasurisë, në pajtim me ligjin në fuqi, pavarësisht nëse ai person ka banuar në atë pronë bashkë me bartësin e të drejtës së pronës”.

Në rastin konkret, KKKP-ja ka vendosur drejtë që M.M. është dashur ta paraqes autorizimin e avokatit. Bartësi i drejtës së pronës R.P. është në spital dhe invalid. Një situatë kësisoji është e mjaftueshme për të konstatuar se ai nuk është vet në gjendje për ta paraqitur kërkesën, andaj dhe atë mund ta përfaqësojë dikush. M.M. është dhëndëri tij dhe, si i tillë, ai nuk është i detyruar ta mbështes vjehrrin e tij sipas të drejtës familjare të Kosovës No.2004/32. Andaj, ai nuk është pjesëtar i familjes. Si pasojë, për të qenë i autorizuar për ta përfaqësuar R.P., meqë, siç ka theksuar edhe KKKP-ja, nuk ekzistojnë situata të jashtëzakonshme të cilat e bëjnë problematike sigurimin e autorizimit të avokatit; në këtë rast ai duhet ta sigurojë autorizimin valid të avokatit.

Megjithatë, Gjykata Supreme mendon se vendimi i KKKP-ës për ta hedhur poshtë kërkesën për shkak të mos sigurimit të autorizimit, nuk është lëshuar në pajtim me dispozitat që kanë të bëjnë me mënyrën e plotësimit të kërkesës.

Neni 11.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-079, parasheh aplikimin mutatis mutandis të dispozitave të Ligjit mbi Procedurën Administrative për procedurën e Komisionit. Neni 39.1 i Ligjit Nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative parasheh:

“Nëse kërkesa e palës së interesuar për fillimin e një procedure administrative nuk është përparitur në pajtim me kërkesat e parapara me Nenin 38 të këtij ligji, personat fizik dhe juridik të cilët kërkojnë veprim nga organi administrativ, duhet të kërkojnë korrigjimin e pasaktësive që përmban kërkesa.”

Në mesin e kërkesave të Nenit 38 të këtij ligji, ekziston obligimi i paraqitjes së kërkesës me shkrim, me datë dhe të nënshkruar nga person apo përfaqësuesi ligjor i personit.

Gjykata Supreme është e mendimit që fjalët *“duhet të kërkojnë korrigjim?”*, në kontekst të një kërkesë të paraqitur para një gjykate, i referohen një kërkesë formale duke përfshirë këtu edhe njoftimin lidhur me pasojat në rast të dështimit për të qenë në pajtueshmëri me këtë meqë kjo zakonisht bëhet gjatë instruksioneve të lëndës në të gjitha procedurat para gjykatave. Ky opinion gjithashtu mbështetet në detyrat dhe përgjegjësitë Sekretariatit Ekzekutiv siç janë të përshkruara në Aneksin II të UA 2007/5 të ndryshuar, në veçanti në

nenet 1.1 (a) dhe 4.1: Nga Sekretariati Ekzekutiv kërkohet “*ndihmë në mbledhjen e kërkesave*” dhe , në kohën e zgjidhjes së kërkesave, “*duhet tu ndihmojë palëve për zgjidhjen e kërkesave*”.

Me qëllim të interpretimit të këtyre dispozitave të UA, Gjykata Supreme, ashtu siq është paraparë me nenin 13 të të njejtit UA, “*...mund të marrë parasysh, me modifikime apo kritere të tilla për të cilat konsideron se janë të nevojshme apo të dubura në rrethana të caktuara, dispozitat e ligjeve në fuqi mbi kompetencat e Gjykatës Supreme lidhur me procedurat civile **mutatis mutandis** dispozitat e Urdhërësës Administrative Nr. 2003/13 të datës 11 qershor 2003 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13 Mbi Themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi çështjet që lidhen më Agjencinë Kosovare të Privatizimit*”.

Neni 28.4 i UA të UNMIK-ut Nr. 2008/6 i ndryshuar dhe zëvendësuar me UA të UNMIK-ut 2002/12 lidhur me kriteret e pranueshmërisë së ankesës parasheh që në rast se kolegji gjyqësor përcakton se kushtet e pranueshmërisë nuk janë plotësuar, duhet të lëshohet një urdhër për paraqitësin e kërkesës, në të cilin duhet të përshruhet një kohë e arsyeshme për kompletimin ose përmirësimin e kërkesës. Ky urdhër duhet të përshkruaj se pse dhe si kërkesa nuk i ka përmbushur kushtet dhe që urdhëri duhet të dërgohet të paraqitësi i kërkesës.

Duke iu referuar interpretimit, Gjykata Supreme konsideron se detyra e Sekretariatit Ekzekutiv që të “lehtësojë grumbullimin e kërkesave” e cila domosdoshmërisht nënkupton grumbullimin e kërkesave të kompletuara, imponon rolin aktiv dhe efektiv në përgatitjen dhe kompletimin e kërkesave me qëllim referimi të Komisioni.

Gjykata Supreme e Kosovës, vëren se në këtë rast, fleta në excel ku përfshihen detyrat e kryera nga Sekretariati Ekzekutiv, tregon se M.M. është kontaktuar jo zyrtarisht më 06 tetor 2008, më 18 shkurt 2009 dhe më 04 mars 2009 dhe atij i është kërkuar ta sillte një autorizim të avokatit. Fleta e excel-it thotë se atij i janë dhënë dy herë nga dy javë dhe njëherë 30 ditë që ta përmbushë këtë kërkesë. Në këtë dokument, gjithmonë është parë një kërkesë e datës 18 mars 2009 për ta kontaktuar paditësin, për ti dhënë atij një afat të ri prej 30 ditësh dhe për ta njoftuar atë se mosdorëzimi i autorizimit brenda afatit të caktuar, mund të çojë deri te

hedhja poshtë e kërkesës. Mirëpo, ky dokument nuk vërteton se kjo kërkesë është bërë dhe i është dërguar përfaqësuesit të paraqitësit të kërkesës.

Duke pasur parasysh pasojat e refuzimit të kërkesës për një procedurë e cila më nuk mund të rifillohet, sipas Nenit 8 të UA 2007/5, të ndryshuar, koha e shpenzuar e kërkesës e tejkalon 03 dhjetorin 2007, për kërkesat pranë KKPK, Gjykata Supreme gjenë se vetëm një kërkesë me shkrim bashkë me një sqarim lidhur me pasojat në rast të mospërmbushjes së kërkesave, lidhur me pranueshmërinë e kërkesës së dërguar palës, mund të çojë deri te refuzimi i kërkesës.

Në këtë rast, nuk është bërë një kërkesë e tillë formale. Pra, përfaqësuesi i paditësit nuk ka mundur të jetë mjaftueshëm i sigurt se kërkesa mund të ishte refuzuar për shkak të mungesës së autorizimit. Kur ai ka kuptuar ndikimin e kësaj mungese, kur ka marrë vendimin e KKPK-së, bashkë me ankesën e tij, ai ka paraqitur edhe një autorizim të të avokatit, të rregullt, të vërtetuar dhe valid.

Si pasojë e arsyeve të dhëna më sipër, sipas Nenit 13.3 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar më Ligjin Nr. 03/L-079, Gjykata Supreme duhet ta pranojë ankesën dhe të lëshojë një vendim të ri.

Me dorëzimin e autorizimit të avokatit, Gjykata Supreme konsideron se kërkesa është complete dhe e pranueshme. Gjykata Supreme më pastaj duhet ta shqyrtojë kërkesën sipas meritës.

Sipas Nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-079, KKPK, dhe në nivel të shkallës së dytë, Gjykata Supreme ka autorizimin për zgjidhjen e konfliktit i cili ka të bëjë me kërkesat mbi pronën e pasurisë, përfshirë këtu edhe pasurinë bujqësore dhe tregtare, duke involvuar këtu edhe rrethanat që kanë lidhje direkte apo që rezultojnë me konfliktin e armatosur, të ndodhur në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit të vitit 1999, ku paditësi nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tij mbi pronën.

Në rastin konkret, çështja lëndore e kërkesës është një ngastër kullosash e cila përbënë një pasuri të paluajtshme bujqësore. Apeluesi sqaron se humbja e posedimit të ngastrës së përmendur ka ndodhur më 10 qershor 1999, për shkak të situatës së përgjithshme të sigurisë dhe për shkak të frikës së tij personale.

Ato elemente dhe koha e humbjes së posedimit në rrethana të mirë njohura të situatës së Kosovës në qershor të vitit 1999 justifikojnë konsiderimin që kërkesa të bie nën juridiksionin e këtij kolegji të Gjykatës Supreme.

Për ta aprovuar riposedimin e pronës, apeluesi duhet ta vërtetojë të drejtën e tij të pronësisë mbi ngastrën në fjalë. Në atë qëllim, ai ka paraqitur një vendim N. Nr. 51/73 të lëshuar më 6 shtator 1985 nga Gjykata Komunale e Podujevës, ku theksohet ndarja e ngastrave të ndryshme dhe posaçërisht ndarja ati e ngastrës kontestuese. Pos kësaj, Sekretariati Ekzekutiv ka dorëzuar listën poseduese Nr. 338 të Zonës Kadastrale të Batllavës, Komuna e Podujevës, ku tregon se ngastra e tokës në fjalë është e regjistruar nën emrin e R.P.-it.

Sipas Nenit 20 të Ligjit Themelor Për Marrëdhënje Pronësore - Jurdike (Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr.6/80), *“e drejta e pronësisë mund të fitohet sipas vet ligjit, në bazë të punës juridike dhe sipas trashëgimisë ...”*

Vendimi i sipër përmendur i Gjykatës Komunale të Podujevës në mënyrë të veçantë i referohet vendimit të trashëgimisë T. Nr.31/69, të lëshuar më 7 nëntor 1969 të Gjykatës Komunale e Podujevës, i cili ka shpallur si trashëgimtarë të vetëm djemtë e të ndjerit B.P.. Në mesin e tyre është edhe R.P.. Pastaj, ai ka vazhduar edhe në ndarjen e pasurisë së paluajtshme, sipas marrëveshjes së trashëgimtarëve, dhe ngastrën në fjalë i ka takuar R.P.-it. Rezultati i këtij vendimi është regjistruar në bazë të shënimeve kadastrale të regjistruara sipas listës poseduese të paraqitur në procedurë.

Andaj, për Gjykatën Supreme është e mjaftueshme që këto dokumente përbëjnë prova për të drejtën e pretenduar dhe konstaton se apeluesi ka vërtetuar pronësinë mbi pasurinë e kërkuar. Si pasojë, Gjykata Supreme duhet ti aprovojë atij ri-posedimin e pasurisë në fjalë dhe duhet ta urdhërojë cilinndo person, i cili ka uzurpuar në mënyrë të paligjshme pasurinë,

që atë ta lirojë brenda 30 ditësh pas dërgimit të këtij aktgjykimi. Mosrespektimi i kësaj urdhërese brenda kohës së cekur, do të çojë deri te dëbimi nga kjo pasuri.

Shpenzimet procedurale:

Sipas Nenit 8.4 të Aneksit II të Urdhëresës administrative (UD) 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët përjashtohen nga shpenzimet e procedurës pranë Sekretariatit Ekzekutiv dhe Komisionit.

Mirëpo, një përjashtim i tillë nuk parashihet për procedurën pranë Gjykatës Supreme.

Si pasojë, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore, të parapara me Ligjin mbi Shpenzimet (Gazeta Zyrtare e KSAK-3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e shpenzimeve gjyqësore aplikohen për procedurat e sjella pranë Gjykatës Supreme.

Kur apeluesi e fiton rastin dhe nuk ka kundërshtim, këto shpenzime gjyqësore duhet ti mbulojë gjykata dhe ato duhet paguar nga burimet buxhetore.

Këshillë Juridike

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes të këshillave të zakonshme apo të jashtëzakonshme.

Antoinette Lepeltier-Durel, kryetare e kolegjit të EULEX-it,

Anne Kerber, gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, gjyqtar

Urs Nufer, regjistrator i Eulex-it